**MIRATOHET**

**SEKRETAR I K.K.T.K.M.**

**SOKOL ISMAILI**

# Relacion

# Projekt restaurimi

# Restaurimi i Muzeut Arkeologjik, Korce



**Grupi i projektimit:**

**Ing.Xhuljana Avdolli** — Xhuljana Avdolli. Digitally signed by Xhuljana Avdolli Date: 2024.06.12 16:03:17 +02'00'

**Ark.Mariola Shahollari** — Mariola Shahollari. Digitally signed by Mariola Shahollari Date: 2024.06.12 15:39:11 +02'00'

**Ark.Klajdi Dinellari** — Klajdi Dinellari. Digitally signed by Klajdi Dinellari Date: 2024.06.12 15:48:55 +02'00'

**DRTK KORCE**

**DREJTOR**

**Dhimitraq Prishka**

Dhimitraq. Digitally signed by Dhimitraq Prishka Date: 2024.06.12 16:25:39 +02'00'

## A. Vendndodhja

**Monument Kulture i Kategorise I**

**Gjinia:** Ndertime te arkitektures vernakulare

**Vendndodhja:** Rruga "Mihal Grameno " ,Lagjia 3 ,Nr.17

**Shpallur:** Me Urdher Nr / 08.01.1977 me institucion te shpalljes "Ministria e Arsimit dhe Kultures"

Objekti ndodhet ne qender te Korces ne lagjen 3 shume prane katedrales .

VENDODHJA E KORCES



POZICIONI I OBJEKTIT NE ZONEN E MBROJTUR




PLANVENDOSJA E OBJEKTIT / ORTOFOTO



## B. Historiku dhe te dhenat arkitektonike

**Muzeu Arkeologjik i Korçës** u krijua në vitin 1985 dhe mori formë më të gjerë e më të plotë pas organizimit të vitit 1990. Ky muze është vendosur në dy banesa karakteristike korçare të fillim shekullit XIX (19-të), të cilat për vlerat arkitektonike të tyre janë shpallur monumente kulture.

MATERIALE ARKIVA -SKICA TE REALIZUARA NE VITET 1976



MATERIALE ARKIVA-FOTO TE REALIZUARA MUZEU ARKEOLOGJIK




FOTOT E MESIPERME NUK KANE TE SHENJAR VITIN KUR JANE BERE , NGA FOTOT MUND TE KUPTOJME DHE SI KA QENE GJENDJA E OBJEKTIT NE ATO VITE . PAS KETYRE FOTOVE ESHTE BERE RESTAURIMI I OBJEKTIT .

MATERIALE ARKIVA-FOTO TE REALIZUARA GJATE NDERHYRJES QE ESHTE BERE PARA VITEVE '90.

FOTOT E MEPOSHTME NUK KANE TE SHENUAR VITIN KUR JANE BERE , NGA FOTOT MUND TE KUPTOJME QE NE OBJEKT ESHTE KRYER NJE NDERHYRJE TOTALE RESTAURUESE, JANE KRYER NDERHYRJE NE CATI , RIBERJE CATIE , NDERHYRJE NE NDERKATE , RIBERJE DYSHEMEJE , RIBERJE E TAVANEVE ETJ .GJITHASHTU ESHTE KRYER HAPJE E DRITAREVE TE MBYLLURA .


25469


25470


25471


25472


25473


25474

## *Pershkrim arkitektonik*

Ndërtesa sot me funksion Muzeu Arkeologjik Korce, ka qënë e ndërtuar si banesë e quajtur (ish-banesa e Fani Pjastos ) Pasuri Kulturore e Kategorise se I-re, e ndodhur në brendësi të Qendrës Historike te qytetit te Korces.

Është një ndërtim i formës 3 katesh me sipërfaqe rreth 140 m2, e tipit me oborr të brendshëm.

Formulimi I brendshëm funksional është me dy ambjente, tip dhomë me korridor të madh dhe me shkallë të vendosura në pjesën anësore. Ambjentet janë të mëdha me dritare të vendosura në tre anët e objektit, që plotesojnë një ndriçim maksimal.

***Pershkrim Konstruktiv***

Persa i përket anës ndërtimore, banesa është e ndërtuar me muraturë guri në dy katet e para dhe me mur guri e tulle në katin e tretë. Ndërkatet janë me konstruksion druri e dysheme druri.

Muret kane nje trashesi rreth 77 cm ne nivelin e katit perdhe dhe 65-70 cm trashesi ne nivelin e katit te pare , ne nivelin e katit te dyte ka mure qe variojne nga 50 cm deri ne 30 cm ne varesi te pozicionit te tyre.

Muratura eshte me llac gelqere dhe e suvatuar me llac gelqere me kashte bazuar ne sondazhet e bera ne objekt.

Objekti ka nje ballkon te dale ne fasaden kryesore me elemente dekorative si kangjellat dhe punimet e gipsit .

Detaje arkitektonike ka ne fasaden e objektit ne pjesen e kornizave te dritareve , korniza nen cati , dhe elemente te tjera ne pjesen e gureve te portes hyrese ne ndertese.

Mbulimi I ndërtesës është realizuar me çati vendi me lënde druri dhe tjegulla vendi.

Përsa i perket arkitekturës është e punuar me fugatime të gurit në katin e parë dhe e alternuar me suvatime dhe fugatime në dy katet e tjera.

## C. Nderhyrjet nder vite

Gjate viteve objekti ka pasur demtime , si rrjedhim ka pasur disa nderhyrje restauruese.

PERIUDHA E NDERTIMIT- OBJEKTI ESHTE NDERTUAR NE MESIN E SHEK.XIX DATIM TE SAKTE NUK KEMI.

VITI 1976 -NGA MATERIALET E ARKIVES PER KETE OBJEKT KEMI MATJE DHE RILEVIME PARA VITIT 1976 DHE NE VITIN 1976 DHE REALIZIMIN E NJE PROJEKTI NE KETO VITE POR NUK KEMI INFORMACION NE LIDHJE ME ZBATIMIN E KETIJ PROJEKTI.

PARA VITEVE '90 - NGA MATERIALET ARKIVORE KEMI FOTO TE NDERHYRJES NE OBJEKT NUK KA VIT KUR ESHTE KRYER RESTAURIMI DHE SJELLJA E OBJEKTIT NE GJENDJEN QE ESHTE SOT, POR NGA FOTOT MUND TE JETE KRYER PARA VITEVE '90.KJO NDERHYRJE ESHTE KRYER NE TE GJITHE OBJEKTIN DHE NE TE GJITHE ELEMENTET KRYESORE TE OBJEKTIT SI DHE E KA RISJELLE OBJEKTIN NE GJENDJEN QE ESHTE DHE SOT. OBJEKTI I RILEVUAR NE VITET 1976 KA PASUR DRITARE TE ZENA ME MUR SI DHE KA QENE NE GJENDJE SHUME TE DEGRADUAR SIC DUKET NGA FOTOT E MESIPERME .

VITI 2010 - NDERHYRJE E VITIT 2010 E CILA PERFSHIN:PUNIME RESTAURIMI CATIE, PUNIME DYSHEMEJE , PUNIME SUVATIMI , INSTALIME ELEKTRIKE, PUNIME MURATURE , FUGATIME MURATURE ETJ.

VITI 2014 - NDERHYRJE E VITIT 2014 E CILA PERFSHIN RESTAURIMIN E BALLKONIT, SUVATIME NE FASADE , FUGATIM MURATURE RESTAURIM FASHATURA DRURI.

VITI 2016-'17 - NDERHYRJE E KETYRE VITEVE PERFSHIN PUNIME SUVATIME DHE RESTAURIME DRITARE NE PJESEN E ZYRES NE KATIN PERDHE.

VITI 2018 - NDERHYRJE E VITIT 2018 PERFSHIN PUNIME MIREMBATJE SUVATIME DHE LYERJE.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMBËTARE E TRASHËGIMISË KULTURORE
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT

**VITI 1976**





**VITET 1990**



**VITI 2010**






**VITI 2014**



**VITI 2018**





## D. Dokumentimi grafik dhe fotografik

FOTO TE GJENDJES EGZISTUESE



















FOTO TE GJENDJES EGZISTUESE



RILEVIMI/FOTO



RILEVIMI / METODA E TREKENDSHAVE



# E.GJENDJE EKZISTUESE

Muzeu (Banesa e Fani Kote Pjastos) ndodhet në gjëndje të amortizuar në pjesën më të madhe te elementeve te saj.

**Faktoret kryesore te problematikave në objekt janë:**

## *1-Termetet*

Objekti ka nje planimetri asimetrike me nje shtrirje ne plan ne forme L duke bere qe te mos kemi perputhje te qendres se inercise me qendren e rendeses, kjo ka ndikuar ne problematikat e ardhura nga veprimi i forcave sizmike.

Megjithate duke qene se kemi te bejme me nje strukture me murature guri me lartesi te konsiderueshme , murature ka pesuar carje vertikale, devijime te muratures, carje ne qemeret e dritareve te cilat kane ardhur si pasoje e levizjeve te muratures .

Nje faktor tjeter i rendesishem eshte dhe veprimi i agjenteve atmosferike te cilat ndikojne ne avancimin e metejshem te ketyre carjeve.

**Si pasoje e termeteve te ndodhura se fundmi ( dt.1 , 2 qershor dhe 31 korrik 2019 ) , objekti ka pesuar demtime te metejshme, si thellim te carjeve dhe plasaritje ne pjesen e qosheve.**




## <ins>*3-Demtimi i mbuleses se catise*</ins>

Nga te dhenat qe disponojme nderhyrjet ne objekt ne pjesen e catise jane kryer se fundmi ne vitin 2010 , mbulesa e catise eshte demtuar me kalimin e viteve dhe si pasoje ka sjelle futjen e lageshtise ne brendesi dhe demtim te muratures. Per kete arsye lageshtia ka depertuar ne murature duke shkaktuar carje dhe plasaritje te suvase dhe renie te saj.

## 4-Veprimi i faktoreve atmosferike.

Fugatimi i objektit eshte demtuar nga veprimi i agjenteve atmosferike dhe temperaturave te uleta gjate stines se dimrit.

Korniza ne pjesen e catise eshte demtuar nga lageshtia dhe reshjet.

Dritaret dhe dyert kane pesuar degradim si pasoje e veprimit te faktoreve atmosferike.

Sic duket dhe nga foto me poshte , tregohen demtimet nga veprimi i agjenteve atmosferike ne objekt.



Degradimi i dritareve, demtimi i suvase



Demtim i kornizes se gipsit , demtim i fugatimit.



Demtim i qosheve me gure.



Demtim i suvase si rezultat i depertimit te lageshtise.



Degradim i drurit, brezave dhe dyerve.



Demtim i suvase nga depertimi i ujrave nga catia.



Demtim i suvase ne fasade

**Duke u nisur nga faktoret kryesore qe kane vepruar ne objekt demtimet e evidentuara ne menyre te permbledhur jane:**

-Demtim i mbuleses se catise , konstruksioni do verifikohet pas hapjes.

-Demtim dhe carje ne suva ne brendesi

-Demtim i fugatimit ne fasada.

-Demtim i muratures , carje ne murature.

-Degradim te materialit te drurit te dritareve dhe dyerve ne fasada.

- Degradim i dyshemeve

-Demtim i elementeve te drurit ne brendesi, fashatura, parapet , shkalle druri etj

## E. Ndërhyrjet Restauruese

**Nderhyrje perforcuese dhe restauruese qe propozohen :**

- Sondazhe ne themele dhe sondazhe te carjeve ne murature
- Pastrim dhe fugatim i mureve ne fasade dhe ne katin perdhe
- Injektime dhe qepje te muratures ne varesi te carjeve
- Rindertim i konstruksionit te catise dhe mbulimit te saj
- Perforcimi me konstruksion metalik
- Prishje dhe riberje e suvase ne brendesi dhe ne fasade
- Riberje e dyshemeve dhe restaurim i shkalleve te drurit
- Zevendesim i dritareve dhe dyerve te demtuara
- Restaurim i elementeve te drurit
- Sistemim i ambjentit perreth

**- Sondazhe ne themele dhe sondazhe te carjeve ne murature**

Perpara fillimit me punimet restauruese do behen sondazhe ne themele per te verifikuar thellesine e themeleve dhe demtimet qe mund te kete themeli. Sondazhe do te behen dhe ne pjesen e konstruksionit te catise per te pare elementet e saj dhe gjendjen e tyre, sondazhe ne pjesen e carjeve ne qoshe te mureve dhe carje te tjera ne murature.

Eshte menduar qe te behet nje drenazhim nga jashte i objektit per te larguar ujerat ne themele. Gjithashtu berja e trotuarit ne perimeter te objektit.

## SONDAZHE PLAN KATI PERDHE



TRA EKZISTUES I CILI DO VERIFIKOHET GJATE PUNIMEVE.

SONDAZHE NE BODRUM VERIFIKIMI I THEMELEVE NE KETE PJESE





KONKLUZIONE: Pas sondazheve te kryera ne nivelin e bodrumit u vu re se gjendja e themeleve eshte relativisht mire , propozojme injektime ne nivelin e themeleve per mitjen e qendrueshmense

## SONDAZHE KATI I PARE

SONDAZHE NE NIVELIN E KATIT TE PARE NE MURATURE





SONDAZHE NE NIVELIN E KATIT TE PARE NE MURATURE





SONDAZH I TRAUT NE PJESEN E TAVANIT NE NIVELIN E KATIT PERDHE



SONDAZHE NE NIVELIN E KATIT TE PARE NE MURATURE





KONKLUZIONE: Pas sondazheve te kryera ne nivelin e katit te pare u verifikua materiali perberes i murатures ne disa pika ku dyshohej qe materiali perberes mund te ishte catme , ne fakt pas hapjes materiali perberes i muratures ishte tulle vendi dhe ne disa pjese murature guri sic duket dhe nga fotot me siper.
Ne pjesen e tavanit ne katin e pare eshte nje tra ne dukje gipsi por pas sondazheve ishte tra metalik ne forme H.Gjate punimeve rekomandohet te shikohet mbeshtetja e tij. Gjithashtu gjate hapjes suvaja ishte me llac gelqere dhe me fije kashte , gjate riberjes se suvase do te ruhet lloji i llacit sipas origjinalit

## SONDAZHE KATI I DYTE




KONKLUZIONE: Pas sondazheve te kryera ne nivelin e katit te dyte u verifikua materiali perberes i murатures ne disa pika ku dyshohej qe materiali perberes mund te ishte catme , ne fakt pas hapjes materiali perberes i muratures ishte tulle vendi sic duket dhe nga fotot me siper.
Ne pjesen e tavanit ne katin e dyte eshte nje tra ne dukje , pas sondazheve trau ishte betonarme .Gjate punimeve rekomandohet te shikohet me mire gjendja e tij dhe nevoja e riberjes apo perforcimit. Ne pjesen mbi murature ku u hap nje pjese e murtures u vu re se kishte prani betoni qe me shume mundesi mund te jete nje brez betonarme ne krye te murtures , gjate kryerjes se punimeve do te verifikohen permasat , gjendja ekzistuesee tij dhe shtrirja ne nivelin e murtures.
Gjithashtu gjate hapjes suvaja ishte me llac gelqere dhe me fije kashte , gjate riberjes se suvase do te ruhet lloji i llacit sipas origjinalit .

**- Pastrim dhe fugatim i mureve**

Fugatimi eshte I demtuar, do behet pastrimi fuges me furce teli dhe riberje e fugatimit sipas teknikes origjinale. Do te shikohet ku ka carje ne murature dhe do behet injektimi me llac. Shiko specifikimet teknike me poshte.

**- Injektime dhe qepje te murtures ne varesi te carjeve**

Carjet ne murature jane te konsiderueshme ne pjesen e qosheve te murtures ne nivelin e katit te dyte ne drejtim horizonatl ne pjesen e tavanit ne qoshe , keto carje evidentohen si nga ana e jashtme dhe ne anen e brendshme per kete arsye pas vendosjes se skelarive nga jashte dhe nga brenda do behen sondazhe te carjeve per te verifikuar thellesine e tyre dhe hapjen e tyre ne menyre qe te vendoset dhe menyra e nderhyrjes .

**- Restaurimdhe rindertim i konstruksionit te catise dhe mbulimit te saj**

Mbulesa e catise per arsye te veprimit te agjenteve atmosferike duhet te behet zvendesimi i tjegullave te vendit dhe kontruksionit mbajtes se saj me te njejtin material si origjinali.

-Per arsye te shkeputjes qe ka ndodhur ne pjesen e qosheve te tavanit , per arsye dhe te rritjes se qendrueshmerise se objektit propozojme perforcimin e objektit ne nivelin e katit te dyte me kollona dhe trare metalike ne menyre qe te mos kemi hapesira shume te medha dhe te krijohet nje lidhje me e mire e objektit si dhe per te perballuar me mire peshen e konstruksionit te catise.

**-Perforcimi me konstruksion metalik**

Përforcimi me elemente metalik është parashikuar në nivelin e katit të dytë , për arsye të lidhjes më të mirë të strukturës së objektit , krijimit të mbështetjes më të mirë të catisë si dhe krijimit të hapësirave ekspozuese më të mëdha duke ruajtur objektin .

Realizimi i perforcimit është parashikuar si ne skice e cila do të përcaktohet dhe nga sondazhet dhe struktura ekzistuese e objektit duke parë nga afër mbështetjen e catisë dhe lidhjen e trarëve të ndërkatit. Në objekt mendohet se nuk ka një lidhje të mirë të muraturës me tavanin si dhe janë krijuar hapësira të mëdha të cilat nuk kanë ndarje apo mbështetje te trarëve. Në objekt është ekzitues një tra beton/arme i cili ben një ndarje të hapësirës së dritës në të cilin mendohet se janë mbështëtur trarët e tavanit.

Në këto pozicione është propozuar vendosja e kollonave dhe trarëve metalike me profile celiku sipas skicimeve të projektit por duke parë dhe në vend gjatë zbatimit.

**- Prishje dhe riberje e suvase ne brendesi dhe ne fasade**

Është menduar që të kryhet prishje e suvasë ekzistuese dhe ribërje e saj , pasi gjëndja e suvasë është e dëmtuar nga lagështia, suvaja të ribëhet sipas teknikës origjinale me gëlqere dhe kashtë.



**- Riberje e dyshemeve dhe restaurim i shkalleve te drurit**

Propozohet riberje e dyshemese per arsye te verifikimit te lendes se nderkatit dhe sigurimin e lidhjes me te mire te objektit dhe zevendesimin e trareve te nderkateve ne varesi te situates pas hapjes se dyshemese. Gjithsesi do të bëhet ruajtje e elementeve të drurit që mund të ripërdoren.

Restaurimi i shkalleve do te behet rrashinimi dhe lyerje e lendes se drurit me antimol dhe vaj lini dhe me pas me llak.

**- Zevendesim i dritareve dhe dyerve te demtuara**

Në projekt parashikohet zëvëndësimi i dritareve të amortizuara me dritare të njëjta me origjinalin si dhe restaurimi i dritareve në gjëndje më të mirë.

**- Restaurim i elementeve te drurit**

Restaurimi i elementeve te drurit eshte e sqaruar ne specifikimet teknike, do te kryhet ne elemente si fashatura te brendshme, parapet shkalle , fashatura dritare dhe dyer etj.

**- Sistemim i ambjentit perreth**

Sistemimi i ambjentit përfshin restaurimin e shtreses me pllaka , pastrim nga bimësia dhe resaturim të mureve të avllisë .

PLANSISTEMIM SHK.1:200



PLANI I KATIT PERDHE/PATOLOGJITE DHE NDERHYRJET



PLANI I KATITE TE PARE/PATOLOGJITE DHE NDERHYRJET



PLANI I KATITE TE DYTE/PATOLOGJITE DHE NDERHYRJET



PLAN CATIE SHK:1:100




DETAJ CATIE SHK:1:30




PRERJE CATIE SHK:1:50



FASADA PERENDIMORE/PATOLOGJITE DHE NDERHYRJET




FASADA JUGORE/PATOLOGJITE DHE NDERHYRJET



FASADA LINDORE/PATOLOGJITE DHE NDERHYRJET




FASADA VERIORE/PATOLOGJITE DHE NDERHYRJET



PRERJA B-B/PATOLOGJITE DHE NDERHYRJET



DETAJ I SHKALLES

SHKALLA SHK.1:20




KORIMANO E SHKALLES SHK.1:10




KORIMANO E SHKALLES SHK.1:10




DETAJET E PORTAVE DHE TE DYERVE Shk.1:30



DETAJ I DRITAREVE Shk.1:20

PAMJE NGA JASHTE



PAMJE NGA NGA BRENDA



DETAJ BALLKONI Shk.1:25












REPUBLIKA E SHQIPERISË
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT

**Në projekt parashikohen dhe punime përforcimi më poshtë renditen punimet e parashikuara:**

SHENIM: NDERHYRJET PERFORCUESE TE PARASHIKUARA
- INJEKTIME NE THEMELE NE PJESEN E BODRUMIT
- INJEKTIM NE THEMELE NE TE GJITHE PERIMETRIN E OBJEKTIT
- INJEKTIME NE MURATURE NE PJESET KU KA CARJE MURATURE PAS PRISHJES SE SUVASE DHE KONTROLLIT TE MURATURES.
- PERFORCIM ME KONSTRUKSION METALIK ME KOLLONA DHE TRARE METALIK NE NIVELIN E KATIT TE DYTE PER RRITJEN E QENDRUESHMERISE SE OBJEKTIT.
-NDERTIM BREZ BETONARME NE KREUN E MURIT NE TE GJITHE MURATUREN PER LIDHJE ME TE MIRE
APO RIPERFORCIM TE BREZIT EKZISTUES NE VARESI TE GJENDJES

Shenim: Pasi te hapet catia do te shikohet n.q.s ne pjesen e siperme te murit ka brez b/a ekzitues , pasi nga sondazhet e bera ne pjesen e brendshme te muratures ka prani te nje brezi betoni si dhe tra betoni keshtu qe mendojme se mund te kete brez dhe ne muraturen perimetrale. Ne rast se kemi brez ekzitues ne varesi te gjendjes se brezit do te behet brez i ri i cili do te lidhet me brezin ekzistues sipas detajeve te paraqitura me siper. Ne rast se nuk ka brez ekzitues do te ndertohet nje brez antisizmik,brez b/a antisizmik i ri mbi murin e gurit ne gjithe perimetrin e tij, i niveluar . Maskimi nga jashte do te behet me imitim fuge ose me kornizen e gipsit sipas vendit.

SHENIM: Se pari do te behet sondazhi i brezit apo trareve ekzistues ne objekt dhe do te gjykohet ne vend pasi te hapet objekti ne prani te mbikqyresit dhe projektuesit te punimeve ne lidhje me menyren e perforcimit te objektit. Nga termetet e fundit te vitit 2019 objekti pesoi plasaritje ne nivelin e lidhjes se muratures me tavanin , duke analizuar shkakun e ketyre plasaritjeve mendojme se ka ardhur si pasoje e lidhjes jo te mire midis trareve te tavanit dhe muratures per kete arsye propozojme ndertimin e nje brezi beton arme ne nivelin e kreut te catise si dhe perforcim me konstruksion metalik kollona dhe trare per lehtesimin e muratures dhe rritjen e qendrueshmerise se objektit.
Me siper propozohet nje menyre e vendosjes se trareve dhe kollonave metalike bazuar ne te dhenat dhe sondazhet e kryera megjithate menyra perfundimtare e vendosjes se tyre do te percaktohet dhe njeher pas zbulimit te catise dhe verifikimit te sakte te gjendjes ekzistuese ne objekt

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS


Brez b/a
Brezi i ri b/a
Tra betoni ekzistues
Struktura e re per perforcim me elemente metalike

NDERHYRJE NE OBJEKT-PERFORCIMI I OBJEKTIT ME PROFILE METALIKE

## Detaje



## Detaje
## Lidhja e brezit te ri me profilin metalik dhe brezin ekzistues




## Prerje 1-1




## Detaji i brezit te ri dhe lidhja me ekzistuesin






## ME POSHTE IMAZHE TE OBJEKTIT PAS RESTAURIMIT

RENDERA



## Restaurimi i Muzeut Arkeologjik, Korce













**Për zbatimin e projektit është e rëndësishme të hartohet njëkohësisht dhe projekti i muzealizimit të brendshëm, projekti i piktures, projekti elektrik, hidrosanitar të cilat duhet të zbatohen në të njëjtën kohë me projektin arkitektonik të hartuar.**

Sokol Ismaili
Digitally signed by Sokol Ismaili
Date: 2024.08.02 13:31:59 +02'00'